

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"S'është çështje inati...", Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson dot Parlamentin!
ADRESA	https://versus.al/politike/seshte-ceshtje-inati-rama-reagon-serish-per-pagat-e-gjyqtarev-e-askush-n-i46555
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:48:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bac5f745a3ccd714527201bea93b0d9027910820ef75fe093bf1edfc3d26ff9a
TEKSTI	77ea8aecf020c61278f07277bf51215c08630e3cd3a5eaf9115f07d88ec5b1cb
PAMJA	7cfe70542e26cc64ed9542afafcc20c6460e9dc8395af8ce07d78b3083162599

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	57d597b436bec17af16d9caba1d3a2760ad0292b647c603a70e556683c8143a2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/57d597b436bec17af16d9caba1d3a2760ad0292b647c603a70e556683c8143a2

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POLITIKË

"S'është çështje inati...", Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson dot Parlamentin!

14 Shtator 2026, 19:31

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[POLITIKË](#) / 14 Shtator 2026, 19:31

"S'është çështje inati...", Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson dot Parlamentin!

Pavarësisht përplasjes publike, Rama thotë se dera për dialog mes pushteteve mbetet e hapur.





Kryeministri Edi Rama ka reaguar në platformën sociale X lidhur me debatin për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke kritikuar publikisht qëndrimin e një gjyqtari dhe mënyrën se si, sipas tij, është interpretuar pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe raporti me buxhetin e shtetit.

“E pabesueshme, po e vërtetë që një gjykatës e kupton kështu pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar...”, shkruan Rama në mesazhin e tij postuar në X.

Sipas tij, askush nuk mund të zëvendësojë Parlamentin dhe as t'i diktojë legjislativit mënyrën se si duhet të votojë.

Rama thekson se vetëm Gjykata Kushtetuese ka të drejtën dhe detyrën të vlerësojë nëse Parlamenti ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën.

Por, sipas kryeministrit, edhe Gjykata Kushtetuese nuk mund t'i diktojë pushtetit legjislativ mënyrën se si duhet të ushtrojë kompetencat e tij.

Ai argumenton se politika e pagave propozohet nga qeveria, miratohet nga Parlamenti dhe zbatohet nga qeveria.

Ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese, sipas Ramës, duhet të bëhet vetëm në rastet kur cenohet një parim apo normë kushtetuese.

Pavarësisht përplasjes publike, Rama thotë se dera për dialog mes pushteteve mbetet e hapur./**Versus.al**

Mesazhi i plote

“E pabesueshme, po e vërtetë që një gjykatës e kupton kështu pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar...”
Kurrë jo, kjo nuk është gjuhë gjykatësi, po gjuhë ultrasi që bërtet në rrugë kundër VAR-it.

Keqardhje dhe disa të vërteta të thjeshta:

Askush nuk e zëvendëson dot parlamentin dhe as nuk e urdhëron dot legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën. Vetëm Gjykata Kushtetuese e askush tjetër, ka të drejtën dhe detyrën t'i thotë se kur e ka ngritur dorën gabim, po as ajo vetë nuk i thotë dot kurrësi pushtetit të pavarur legjislativ se si duhet ta ngrejë dorën.

Politikën e pagave e propozon vetëm qeveria, e miraton vetëm parlamenti dhe e zbaton vetëm qeveria. Gjykata Kushtetuese ndërhyr vetëm nëse cenohet një parim a një normë kushtetuese, që ligjvënësit duhet ta riparojnë pa u cënuar në pavarësinë e tyre, siç e shohin ata të udhës të shprehen me votën e tyre.

Nëse largqoftë, shoqatat e prokurorëve e të gjykatësve kanë vendosur që me mjete politike dhe juridike të koordinuara me zyrat e prokurorive e të gjykatave si një ushtri e rreshtuar kundër qeverisë, të na imponohen me kallzime, sigurime a përmbarime për të rritur pagat e tyre, atëherë jemi përpara një sfide të një lloji të ri, e cila nuk na tremb po na shqetëson pamasë. Por ne nuk duam të jetë kështu dhe unë nuk dua ta lejoj që të ndodhë kështu, sepse ndryshe nga si e mendon ky gjykatësi mediatik, kjo e pagave stratosferike, për ne nuk është çështje inati po sfida shtetbërjeje europiane e Shqipërisë.

Është shumë e thjeshtë. Tryeza e përgatitur për takimin e kërkuar dhe të anuluar vazhdon të jetë gati. Në 17 shtator mbaron vetëm ky episod i tensionuar publikisht, që mund dhe duhet të ishte shmangur, por nuk shteron nevoja për të komunikuar mes pushteteve të pavarura. Përkundrazi, ajo nuk lindi nga episodi i pagave dhe do të jetë edhe më e madhe në çdo hap deri në anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Por ne tryezën dhe gatishmërinë kemi, të tjerat janë në gjykimin e gjykatësve:-)



POLITIKË

[Gjyqtarët rritën pagat, Braçe: Të na kërkojnë ndjesë, vendimi i tyre mori kompetencat e Kuvendit](#)

14 Shtator 2026, 16:11

^ekstrakti^



POLITIKË

[Apeli i GJKKO-së pranon kërkesën e ish-presidentit, Ilir Meta del nga "kafazi"](#)

14 Shtator 2026, 15:23

^ekstrakti^



POLITIKË

["GJKKO i konfiskon çdo vit krimit të organizuar", Rama nxjerr shprehjen e gjyqtarit për rritjen e pagave: S'është parë në histori](#)

14 Shtator 2026, 12:48

^ekstrakti^



POLITIKË

["Asnjë pushtues nuk e ka shpopulluar vendin si Rama", Berisha pas kthimit nga SHBA: Kërkuam mbështetje](#)

14 Shtator 2026, 11:52

^ekstrakti^



POLITIKË

["Nuk po na lejohej të marrim nga qesja", Rama nxjerr qëndrimin e Pëllumbit për pagat: E pabesueshme që një gjykatës e sheh kështu buxhetin](#)

13 Shtator 2026, 19:13

^ekstrakti^



POLITIKË

[Takimi me banorët e Poliçanit për "Territorialen", Rama: Ndryshon vetëm fakti që nuk do keni më kryebashkiak](#)

13 Shtator 2026, 17:42

^ekstrakti^



POLITIKË

["Nuk pranojmë kërcënime". Mitsotakis mesazh për Turqinë: Duam dialog pa tensione](#)

13 Shtator 2026, 17:24

^ekstrakti^





POLITIKË

Bojkotuan mbledhjen me Ramën, këshilltarja bashkiake e Poliçanit: Nuk i pëlqeu ajo që i thashë

13 Shtator 2026, 17:06

^ekstrakti^

Të fundit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.